



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr.222, datë 29.06.2021

**PËR CAKTIMIN ME SHORT TË RELATORIT PËR PROCEDURËN E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE FIGURËS SË KANDIDATIT QË KA KANDIDUAR PËR POZICION DREJTUESI, TË KUALIFIKUAR ME VENDIMIN NR. 220, DATË 29.06.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në nenet 159, pika 2, 190, pika 2, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 2-7, të nenit 32, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në pikën 2, Seksioni A, Kreu V, të Vendimit nr. 171, datë 27.09.2019, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e Rregullores për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin, emërimin si magjistrat dhe caktimin në pozicion të kandidatëve për prokurorë, si dhe për zhvillimin e karrierës së prokurorëve”, i ndryshuar, në nenin 9, pika 4, të Vendimit nr. 200, datë 23.09.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë “Për miratimin e rregullores mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe me propozimin sipas relacionit të Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

**VENDOSI:**

1. Caktimin e relatorit për procedurën e verifikimit të pasurisë dhe figurës së kandidatit që ka kandiduar për pozicion drejtuesi, kualifikuar me Vendimin nr. 220, datë 29.06.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

- Durim Bedini kandidat për Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, Relator z. Moisi Duda

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**





ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
NURTHAN SEITI

ANËTAR  
ELOIDA GOXHI

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ANËTAR  
MOISI DUDA

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ